



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM
Dt. 20.04.2021, Nr. 09-111/01-16495



Në bazë të nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nenit 20 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/-032 për Arsimin Parauniversitar, 67 dhe 68 të Ligjit Nr.06/0L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zv.Drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, Komuna e Drenasit, bënë këtë:

R I S H P A L L J E T E K O N K U R S I T

Për plotësimin e vendeve të punës:

1. Zëvendësdrejtor i SHML “ GJ.K.Skënderbeu ” në Drenas
2. Zëvendësdrejtor i SHFMU” Rasim Kiçina ” në Drenas

Lloji i pozitës : **Jo karrierë;**

Numri i pozitave : **(2) dy;**

Titulli i mbikqyrësit: **Drejtori i Drejtorisë për Arsim;**

Grada/Koficjenti- **7.8 për Zv.Drejtor në arsimin e mesëm të lartë;**

Grada/Koficjenti- **7.2 për Zv.Drejtor në arsimin e mesëm të ulët;**

Orët : **40 ;**

Kohëzgjatja e emërimit : **Katër (4) vite, me mundësi vazhdimi.**

Qëllimi i vendit të punës :

Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionin edukativo – arsimor.

Kushtet:

Kushtet që duhet ti plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs janë:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit;
- Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
- Katërveçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Bachelor katërveçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për për licencim të të mësimdhënësve ose të jetë në procedurë të licencimit;
- Të ketë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim dhe menaxhim në arsim të aprovuar nga MASHT-i, sipas rekomandimit të KSHLM;
- Të kenë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës,tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor;

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

1. Zëvendës drejtori i institucionit edukativo – arsimor ka përgjegjësi që në bashkëpunim me drejtorin e shkollës, të asistojë në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshier:

- 1.1. Përgaditjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo – arsimor dhe raportet periodike apo vjetore;
- 1.2. Përdorimin efektiv dhe efikas të sistemit të informatave për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlidhura të praktikës, sigurimin dhe përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë tërë vitit shkollor;
- 1.3. Detyra të caktuara për përzgjedhjen e mësimit, vlerësimin e mësimit, disiplinën në institucionin edukativo – arsimor dhe çështje tjera të cilat kanë të bëjnë me mësimit dhe punëtorët tjerë nga stafi mbështetës i shkollës;
- 1.4. Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- 1.5. Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo – arsimor;
- 1.6. Bashkëpunon me Këshillin Drejtues të Institucionit edukativo – arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimitarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo – arsimor;
- 1.7. Siguron ambjent të sigurtë dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucion, duke përfshier dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve;
- 1.8. Kujdeset për ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo MASHT;

Dokumentet e kërkuara :

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. Diplomen e fakultetit të kryer për nivelin përkatës (e noterizuar- vërtetuar);
3. Diploma duhet të jetë e profilit arsimor, në bazë të normativit profesional për arsimin e përgjithshëm;
4. Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilin dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
5. Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhnë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
6. Dëshminë për përvojën e punës;
7. Konceptin e planit zhvillimor të institucionit edukativo – arsimor për të cilin ka konkuruar. Koncepti duhet të bazohet në fushat e cilësisë në arsim dhe të ketë 5-10 faqe tekst (një faqe për një fushë) me hapësirë 1., fonti i shkronjave 12, arial). Koncepti dorëzohet si pjesë e portofolios, por është edhe pjesë përbërëse kryesore e intervistës;
8. Letërreferencë me përmbajtje dëshmuuese për punën dhe angazhimet paraprake nga një institucion publik-kredibil (si MASHT, DKA, Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë dhe individ me të cilët ka punuar ngushtë në programe të ndryshme për arsim);
9. Letër motivuese për vendin e punës ku konkurren;
10. Portofolion profesionale;
11. Kandidati/ja për drejtor nuk mund të jetë në funksion udhëheqës politik gjatë tri viteve para aplikimit – dëshmohet edhe me Deklaratën për Betim;
12. Biografinë/Curriculum Vitae (CV);
13. Licencën e mësimit, ose dëshminë se është në proces të marrjes së licencës;
14. Diplomë/certifikatë për menaxhim dhe udhëheqje në arsim;
15. Dokumentet e dorëzuara duhet të jenë origjinale dhe të vlefshme.

Ruajtja e vendit të punës:

Drejtorëve të institucioneve edukativo – arsimore të cilëve u është ndërprerë kontrata e punës në arsim, u ruhet vendi i punës në institucionet shkollor brenda komunës në profilin përkatës si personel edukativo – arsimor sipas U.A.(MASHT) Nr.151/2020.

Informata të përgjithshme :

Aplikacionet merrën dhe dorëzohen me dokumente të kompletuara në Zyrën nr.10,11,12 në Komunën e Drenasit. Për të marrë një kopje të Planit aktual zhvillimor në institucionet e lartëcekura edukativo-arsimore, kandidati duhet t'i drejtohet Drejtorit të shkollës, ose personit të cilin e ka autorizuar KDSH. Data e njoftimit në web faqen; [konkursi.rks-gov.net](https://kk.rks-gov.net), është prej dt; 20.04.2021 deri me dt; 19.05.2021, ndërsa data e aplikimit është nga data **20.05.2021** deri me datën **03.06.2021**. Përveq web faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në web-faqe zyrtare të Komunës <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/> Dokumentet e dërguara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga Komisioni.

Me respekt!

Muhamet Gjoka

Drejtor i Drejtoratit për Arsim në Drenas

Drenas, 20.04.2021

